

---

## OPERATORI I BLERJEVE TË PËRQËNDRUARA

Tiranë, më 03.07.2024

### PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

#### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS:** "BLERJE DETERGJENT, HIPOKLORIT NATRIUMI, INSEKTICIDE DHE RODENTICID PËR QENDRËN SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA" E NDARË NË 3 (TRE) LOTE si më poshtë:

**LOTI I. "BLERJE DETERGJENT PËR QENDRËN SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA".**

**LOTI II. "BLERJE HIPOKLORIT NATRIUMI PËR QENDRËN SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA".**

**LOTI III. "BLERJE INSEKTICIDE DHE RODENTICID PËR QENDRËN SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA".**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(FPP) 39224100-9, 33711900-6, 39224340-3, 39831200-8**

**VLERA E FONDIT LIMIT:** "BLERJE DETERGJENT, HIPOKLORIT NATRIUMI, INSEKTICIDE DHE RODENTICID PËR QENDRËN SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA" E NDARË NË 3 (TRE) LOTE me vlerë të përgjithshme të fondit limit: **21,302,667** (njëzetë e një milion e treqind e dy mijë gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) Lekë pa TVSH ose ose **212,284** (dyqind e dymbëdhjetë mijë e dyqind e tetëdhjetë e kater) EURO pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë date 02.07.2024 është 100.35 lekë.

- **LOTI I. "BLERJE DETERGJENT PËR QENDRËN SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA"** me afat të marrëveshjes kuadër 24 muaj, me fond limit të marrëveshjes kuadër me fond limit të 19,092,667 (nëntëmbëdhjetë milion e nëntëdhjetë e dy mijë e

gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH ose **190,261** (njëqind e nentëdhjetë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e një) EURO pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë date 02.07.2024 është 100.35 lekë.

- **LOTI II.** "BLERJE HIPOKLORIT NATRIUMI PËR QENDRËN SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA" me afat të marrëveshjes kuadër 24 muaj me fond limit të marrëveshjes kuadër: 1,820,000 (një milion e tetëqind e njëzetë mijë) lekë pa TVSH ose **18,137** (tetëmbëdhjetë mijë e njëqind e tridhjetë e shtatë) EURO pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë date 02.07.2024 është 100.35 lekë.
- **LOTI III.** "BLERJE INSEKTICIDE DHE RODENTICID PËR QENDRËN SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA" me afat të marrëveshjes kuadër 24 muaj me fond limit të marrëveshjes kuadër: 390,000 (treqind e nëntëdhjetë mijë) lekë pa TVSH ose **3,886** (tre mijë e teteqind e tetëdhjetë e gjashtë) EURO pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë date 02.07.2024 është 100.35 lekë.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor, **Operatori i Blerjeve të Përqendruara**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

## **LOTI I "BLERJE DETERGJENT PËR QENDRËN SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA"**

### **I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

#### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”te ndryshuar.

#### **2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

##### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

## 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros, pra 39% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/a dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:* Vlera e kërkuar jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit të këtij loti është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: *dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;*

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2021, 2022, 2023) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, u përcaktohet se: “*Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit*”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: *.....Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.*”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e

kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

### 2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 39% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
  - a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
  - b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimi, për realizimin e kontratës me sukses.

2. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë **një deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** në adresën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët të sigurojnë autoritetin kontraktor se transporti i mallit do të realizohet në kohë dhe në vendin e caktuar nga Autoriteti Kontraktor.

3. Operatori ekonomik duhet të disponojë **1 (një) mjet për transportin e mallrave** objekt prokurimi, i cili mund të jetë në pronësi/qira/huapërdorje.

Për sa më sipër operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë të dhënat për metin sipas formatit të mëposhtëm:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Statusi
1			Pronesi/qira/huapërdorje

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, nëse janë ne pronësi, të disponohet dokumenti certifikatë pronësie e mjetit, leje qarkullimi e vlefshme, certifikata e kontrollit teknik të vlefshëm, polica e sigurimit të vlefshëm të mjetit.
- b) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, nëse janë me qira/ huapërdorje, të disponohet kontrata e qirasë/ huapërdorjes, dokumenti që vërteton regjistrimin leje qarkullimi, certifikata e kontrollit teknik të vlefshëm, si dhe polica e sigurimit të vlefshëm të mjetit.

**Shënim:** *Kriteri nr.3 konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit te vetedeklarimit shtojca 8. Dokumentet e kerkuara me siper do te paraqiten ne rast se operatori kualifikohet i pari, por perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit ose nese kerkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, Autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet për mjetin që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit sipas afatit të lëvrimit. Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar një minimum të mjeteve që operatori ekonomik duhet të ketë ne dsipozicion për zbatimin e kontratës, duke marrë parasysh llojin e mallit qe do te transportohet, aftin e marreveshjes kuadër që është deri në 24 muaj.

4. Operatori ekonomik, për të realizuar shperndarjen e mallrave objekt prokurimi, si dhe shërbimin e transportit duhet të ketë punësuar minimalisht 2 (dy) punonjës, si më poshtë:

Stafi	Nr.
Shofer	1
Punetore te thjeshte	1
<b>Total</b>	<b>2</b>

Për të vërtetuar këtë pikë, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

-Për punonjesit te paraqitet:

- Kontratë pune.

Per punonjesit shofer te paraqitet:

- Leje drejtimi përkatëse e mjetit.
- Kontrate pune

**Shenim:**

Në lidhje me kërkesën që OE të disponojë 1 person me profesionin shofer, OE mund të paraqesë edhe 1 punonjës, që jo domosdoshmërisht është i regjistruar në listëpagesat e shoqërisë si shofer, por që disponon lejen e drejtimit përkatës të mjetit, dhe mund të realizojë me sukses shërbimin e transportit të mallrave, objekt prokurimi, brenda afateve të ekzekutimit të kontratës

**Per punonjesit qe do te deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor per te gene pjese e planit te zbatimit te kontrates.**

**Shënim:** *Kriteri nr.4 konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit te vetedeklarimit shtojca 8. Dokumentet e kerkuara me siper do te paraqiten ne rast se operatori kualifikohet i pari, por perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit ose nese kerkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Numri minimal prej 2 punonjësish, përkatësisht 1 (një) shofer dhe 1 (një) punëtor i thjeshtë, që operatori ekonomik duhet të ketë ne dispozicion, është kërkuar duke u bazuar në numrin minimal të 1 (një) automjeti për kryerjen e transportit të mallrave objekt prokurimi si dhe 1 (një) punonjës për shkarkimin e mallrave në ambientin e caktuar nga Autoriteti Kontraktor. Numri i punonjesve te kerkuar eshte minimal, duke marre ne konsiderate, sasine, llojin e mallit objekt prokurimi.

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

**Shënim:**

*Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetin ekonomik – financiar (pika 1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetin teknik (pika 1 të seksionit 2.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të skualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar.*

## LOTI II. "BLERJE HIPOKLORIT NATRIUMI PËR QENDRËN SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA"

### Shtojca 7

#### I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

##### 1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"te ndryshuar.

##### 2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

###### 2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

###### 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros, pra 39% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"te ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023"Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar ku përcaktohet se: " Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata". Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit te këtij është brenda kufirit të përcaktuar ne nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"te ndryshuar ku përcaktohet se; Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi

nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.

### 2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 19% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
  - a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
  - b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimi, për realizimin e kontratës me sukses.

2. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë **një deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** në adresën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët të sigurojnë autoritetin kontraktor se transporti i mallit do të realizohet në kohë dhe në vendet e caktuara nga Autoriteti Kontraktor.

3. Operatori ekonomik duhet të disponojë **1 (një) mjet për transportin e mallrave** objekt prokurimi, i cili mund të jetë në pronësi/qira/huapërdorje.



Për sa më sipër operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë të dhënat për mjetin sipas formatit të mëposhtëm:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Statusi
1			Pronesi/qira/ huapërdorje

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, nëse janë në pronësi, të disponohet dokumenti certifikatë pronësie e mjetit, leje qarkullimi e vlefshme, çertifikata e kontrollit teknik të vlefshëm, policia e sigurimit të vlefshëm të mjetit.
- b) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, nëse janë me qira/ huapërdorje, të disponohet kontrata e qirasë/ huapërdorjes, dokumenti që vërteton regjistrimin leje qarkullimi, çertifikata e kontrollit teknik, si dhe policia e sigurimit të vlefshëm të mjetit.

**Shënim :** Kriteri nr.3 konsiderohet i përmbushur me plotesimin e formularit të vetedeklarimit shtojca 8. Dokumentet e kerkuara me sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, Autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet për mjetet që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit sipas afatit të lëvrimit. Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar një minimum të mjeteve që operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion për zbatimin e kontratës, duke marrë parasysh afatin e marreveshjes kuadër që është deri në 24 muaj.

4. Operatori ekonomik, për të realizuar shpërndarjen e mallrave objekt prokurimi, si dhe shërbimin e transportit duhet të ketë punësuar minimalisht 2 (dy) punonjës, si më poshtë:

Stafi	Nr.
Shofer	1
Punetore të thjeshtë	1
<b>Total</b>	<b>2</b>

Për punonjës të shofer të paraqitet:

- Leje drejtimi përkatëse e mjetit.
- Kontrate pune

Për punonjës të punëtor të thjeshtë të paraqitet:

- Kontrate pune

Per punonjesit qe do te deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor per te qene pjese e planit te zbatimit te kontrates.

**Shenim:**

Në lidhje me kërkesën që OE të disponojë 1 (një) person me profesionin shofer, OE mund të paraqesë edhe 1 (një) punonjës, që jo domosdoshmërisht është i regjistruar në listëpagesat e shoqërisë si shofer, por që disponon lejen e drejtimit përkatës të mjetit, dhe mund të realizojë me sukses shërbimin e transportit të mallrave, objekt prokurimi, brenda afateve të ekzekutimit të kontratës.

Per punonjesit qe do te deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor per te qene pjese e planit te zbatimit te kontrates.

**Shënim:** *Kriteri nr.4 konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit te vetedeklarimit shtojca 8. Dokumentet e kerkuara me siper do te paraqiten ne rast se operatori kualifikohet i pari, por perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit ose nese kerkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Numri minimal prej 2 (dy) punonjës, përkatësisht një shofer dhe një punëtor i thjeshtë, që operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion, është kërkuar duke u bazuar në numrin minimal 1 (një) automjet për kryerjen e transportit të mallrave objekt prokurimi si dhe për shkarkimin e mallrave në ambjentin e caktuar nga Autoriteti Kontraktor për realizimin e kontratës. Numri i punonjesve te kerkuar eshte minimal, duke marre ne konsiderate, sasine, llojin e mallit objekt prokurimi.

**Shenim:** *Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (pika 1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (pika 1 të seksionit 2.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të skualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar.*

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

# LOTI III. "BLERJE INSEKTICIDE DHE RODENTICID PËR QENDRËN SPITALORE UNIVERSITARE "NËNË TEREZA"

## I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

### 1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"te ndryshuar.

### 2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

#### 2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

#### 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021, 2022, 2023), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros, pra 39% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"te ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023"Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar ku përcaktohet se: " Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata". Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

*Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:* Vlera e kërkuar jo më e vogël se 39% e vlerës së fondit limit te këtij është brenda kufirit të përcaktuar ne nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik"te ndryshuar ku përcaktohet se; Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure

prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave.

### 2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në vlerën **jo më pak se 19% e vlerës së fondit limit**. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:
  - a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
  - b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 55, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit të këtij loti, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Ky kriteri garanton Autoritetin Kontraktor se operatori ekonomik pjesëmarrës ka një veprimtari ekonomike të sukseshme dhe do të realizojë me sukses kontratën objekt prokurimi.

2. Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë **një deklaratë**, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë **shërbimin e transportit** në adresat e përcaktuara nga autoritetet kontraktore.

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët të sigurojnë autoritetin kontraktor se transporti i mallit do të realizohet në kohë dhe në vendet e caktuara nga Autoriteti Kontraktor.

3. Operatori ekonomik duhet të disponojë **1 (një) mjet për transportin e mallrave objekt prokurimi**, i cili mund të jetë në pronësi/qira/huapërdorje.

Për sa më sipër operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë të dhënat për metin sipas formatit të mëposhtëm:

Nr.	Lloji i mjetit	Targa	Statusi
1			Pronesi/qira/perdorim

- a) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, nëse janë në pronësi, të disponohet dokumenti certifikatë pronësie e mjetit, leje qarkullimi e vlefshme, çertifikata e kontrollit teknik të vlefshëm, polica e sigurimit të vlefshëm të mjetit.
- b) Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, nëse janë me qira/ huapërdorje, të disponohet kontrata e qirasë/ huapërdorjes, dokumenti që vërteton regjistrimin leje qarkullimi, çertifikata e kontrollit teknik të vlefshëm, si dhe polica e sigurimit të vlefshëm të mjetit.

**Shënim 3.:** *Kriteri nr.3 konsiderohet i përmbushur me plotesimin e formularit të vetedeklarimit shtojca 8. Dokumentet e kerkuara me sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kerkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentim:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, Autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet për mjetet që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit sipas afatit të lëvritimit. Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar një minimum të mjeteve që operatori ekonomik duhet të ketë në dispozicion për zbatimin e kontratës, duke marrë parasysh aftin e marreveshjes kuadër që është deri në 24 muaj.

4. Operatori ekonomik, për të realizuar shpërndarjen e mallrave objekt prokurimi, si dhe shërbimin e transportit duhet të ketë punësuar minimalisht 1 (një) punonjës, si më poshtë:

Stafi	Nr.
Shofer	1
<b>Total</b>	<b>1</b>

Për punonjësin shofer të paraqitet:

- Leje drejtimi përkatëse e mjetit.
- Kontrate pune

**Shënim:**

Në lidhje me kërkesën që OE të disponojë 1 person me profesionin shofer, OE mund të paraqesë edhe 1 punonjës, që jo domosdoshmërisht është i regjistruar në listëpagesat e shoqërisë si shofer, por që disponon lejen e drejtimit përkatës të mjetit, dhe mund të realizojë me sukses shërbimin e transportit të mallrave, objekt prokurimi, brenda afateve të ekzekutimit të kontratës.

Per punonjesit qe do te deklarohen, detyrimisht do ti paraqiten Autoritetit Kontraktor per te qene pjese e planit te zbatimit te kontrates.

**Shënim:** *Kriteri nr.4 konsiderohet i permbushur me plotesimin e formularit te vetedeklarimit shtojca 8. Dokumentet e kerkuara me siper do te paraqiten ne rast se operatori kualifikohet i pari, por perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit ose nese kerkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Numri minimal prej 1 (një) punonjësi, përkatësisht një shofer që operatori ekonomik duhet të ketë ne dispozicion, është kërkuar duke u bazuar në numrin minimal 1 (një) automjet për kryerjen e transportit dhe shpërndarjen e mallrave në ambjentin e caktuar nga Autoriteti Kontraktor. Numri i punonjesve te kerkuar eshte minimal, duke marre ne konsiderate, sasine, llojin e mallit objekt prokurimi.

**Shenim:** *Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike –financiare (pika 1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (pika 1 të seksionit 2.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të skualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar.*

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.**

Data e publikimit të njoftimit është 04.07.2024 dhe data e zhvillimit të procedurës së prokurimit elektronik është 05.08.2024 **ora: 11:00** në faqen e internetit [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al), Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.